


ANKIMET DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE (KEGjDP)

Ankesat/kërkesat ndaj çdo sjelljeje ose veprimi të inxhinierëve hidroteknik apo personave fizikë/juridik si edhe specialistëve të nivelit jo inxhinier, si edhe personave jo kompetent në fushën e veprimtarisë hidroteknike, i drejtohen Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

Detyrat kryesore të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij, janë:

- të shqyrtojë ankesë/kërkesat sipas fazave të verifikimit, të refuzimit dhe gjykimit, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- mbikëqyrë zbatimin e statutit, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, kodeve dhe rregulloreve teknike të Urdhrit, sipas përcaktimeve në këtë ligji;
- kryen procedurë administrative dhe për shkeljet vendos masa disiplinore: i. dënim me gjobë, ii. dënim i natyrave të tjera.
- kryen procedurë administrative për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave/kërkesave të vendimeve të Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional të Urdhrit.



Për shqyrtimin e kërkesave/ankesave për procedim administrativë, pranë Urdhrit funksionon Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjykimit disiplinor profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, përkatësisht: Kryetari i Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional; një përfaqësues nga Këshilli i Përgjithshëm. c) një nga Kryesia e Urdhrit. ç) dy inxhinierë hidroteknikë, jashtë Urdhrit.

